



REPUBIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

01Nr 060-32475 2020

Klinë, 25. 09. 2020

PROCESVERBAL

I Seancës së rregullt, të punës së Kuvendit të Komunës të Klinës, mbajtur më 25. 09. 2020, filluar në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Seanca u organizua në respektim të rregullave anti covid të sugjeruar nga QKMF në Klinë dhe ato të përgjithshmet nga IKSHPK. Përveç anëtarëve të Kuvendit, kryetarit të Komunës, Nënkryetarit, kom. i Policisë, Radio "Alba", dhe drejtorë të drejtorive, nuk kishte pjesëmarrës tjerë në sallë pasi që këto ishin rekomandimet e QKMF-së. Anëtarët e kuvendit dhe pjesëmarrësit e tjerë u sistemuan nëpër ulëse të kuvendit në distance të caktuara 1.5-2 metra nga njeri tjetri.

Seancën e hapi kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi i cili përshëndeti gjithë të pranishmit dhe i falënderoi për pjesëmarrje. Ai konstatoi se materiali për seancë është pranuar me kohë bashkë me rendin e ditës. Për Rendin e Ditës, kryesuesi theksoi se në seancën e kaluar kuvendi ka nxjerrë një vendim për çështjen e pagesave të shujtave të arsimtarëve dhe se pas konsultimeve paraprake me kryetarin e Komunës, menduam ta fusim në rend dite vendimin për tërheqjen e ankesës së bërë nga Komuna për këtë çështje. Kryesuesi pasi pyeti nëse ka dikush nga anëtarët propozim për rendin e ditës, e vuri në aprovim propozimin për futje në rend dite të propozim vendimit për tërheqjen e ankesës. Me vota unanim u miratua rendi i ditës më propozimin e bërë nga kryesuesi.

Pas aprovimit të Rendit të Ditës, para se të kalohet në pikën e parë, fjalën e kërkoj znj. Shukrije Shala, anëtare e Kuvendit.

Znj. Shukrije Shala: Të ndërruar pjesëmarrës. Meqenëse në mandatin e tretë si anëtare nga radhët e AAK-së, kalova në radhët e subjektit politik të PDK-së, edhe pse u angazhova maksimalisht në PDK, mbeta jashtë kuvendit të Komunës. Tani që e fitova ulësen me zëvendësim, ju njoftoj se mandatin tim nga sot ja kthej AAK-së, aty ku isha tre mandate radhazi. Me respekt.

z. Petrit Palushaj: Përshëndetje të gjithëve. Falënderoj znj. Shukrije Shala për ardhjen në AAK dhe bashkëngjitje grupit tonë kuvendar. Znj. Shala nuk do të i mungojë hapsira brenda partisë dhe brenda grupit tonë kuvendar. E falënderoj shumë në emrin tim dhe të grupit kuvendar të AAK-së.

Kryesuesi konstatoi se prezent në sallë janë 22 anëtarë të Kuvendit. 4 anëtarë mungojnë me arsye ndërsa Besart Hoti pritet që të i bashkëngjitet kësaj seance.

Pika 1 e Rendit të Ditës: Arsyetimi i mungesave

Kryesuesi theksoi se në lidhje me mungesat e anëtarëve të Kuvendit e sqaroi më lartë.

Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Përshëndetje për të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe të gjithë ju që jeni prezent. Në procesverbalin e mbledhjes së kaluar figurojnë të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë se unë në diskutimin tim si dhe shumica nga ju jeni pajtuar dhe keni votuar pro kërkesës së mësimdhënësve për pagesën e shujtave sipas marrëveshjes së dy ministrive dhe sindikatës së arsimtarëve. Tani, me qellim që të i ikim shpenzimeve të gjykatave pasi që një grup i mësimdhënësve përmes avokatit të tyre kanë bërë ankesë siç e dini dhe se inspektori jua ka kthyer përgjigjen në favor të tyre, një pjesë tjetër nuk kanë bërë akoma, ndërkohë që ne si komune kemi bërë ankesë, pra me qellim që të i ikim shpenzimeve të pa nevojshme gjyqësore e që janë të mëdha, ne kërkojmë që të na jepni mbështetjen e nevojshme ju si kuvend që ta tërheqim ankesën e bërë. Pagesat gjithsesi bëhet nga përmbaruesi ndërkaq ne të angazhohemi që ato mjete të i tërheqim nga ministria e financave dhe ministria e Arsimit pasi që këto dy ministri janë nënshkruese të marrëveshjes.

Procesverbalin me propozimin e kryetarit u vendos në votim dhe pa asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim u MIRATUA me 22 vota për.

Pika 3 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i rekomandimeve të KPF-së.

Kryesuesi theksoi se nga të gjitha rekomandimet, në rend dite janë vetëm ato që është kërkuar votimi i juaj, të tjerat rekomandime janë referuar nëpër drejtorin të caktuar.

Me 22 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratuan në pako të gjitha rekomandimet për Kuvend.

Pika 4 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i draft buxhetit të komunës për vitin 2021-2023

Në emër të drejtorit i cili mungon për shkak të gjendjes jo të mirë shëndetësore, fjalën e merr zv. drejtori, Ajet Sejdiu.

z. Ajet Sejdiu, zv. drejtor i FEZH: Të nderuar të pranishëm, drejtoria e FEZH menjëherë pas marrjes së qarkores së parë buxhetore është angazhuar me tërë stafin dhe të tjerë që të përgatisë kornizën buxhetore për vitin 2021-2023. Drejtoria e Financave duke u bazuar në ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, ligjin për financat e pushtetit lokal, statusin e Komunës dhe planin e punës së kësaj drejtorie, është obliguar që debatet të i zhvilloj online për shkak të epidemisë aktuale. Kategoritë buxhetore nga qarkorja e parë dhe e dytë kanë ndryshuar në qarkoren e tretë. Lidhur me këtë, unë po e lexoj në pika të shkurtra pasi që materialin e keni të gjithë. Në

qarkoren e parë buxhetore të datës 15. 05. 2020 lëshuar nga MF, kufijtë buxhetor për komunën e Klinës kanë qenë: Për vitin 2021 10.911.338 euro. Për vitin 2022, 12.304.713 euro dhe për vitin 2023, 12. 643, 140 euro. Ndërsa qarkoren e dytë të datës 11. 08. 2020 janë caktuar kufijtë e shpenzimeve për kategoritë në kuadër të kufijve sipas qarkores së parë: 2021paga-6.297.124 euro. 2021 Mallra dhe shërbime-1.211.000 eu. 2021 Komunali-180.000 eu. 2021Subvencione- 305.000 eu. 2021 kapitale- 2.918.214 euro. Mirëpo për arsye të nën performacës së të hyrave buxhetore si rezultat i pandemisë , ministria e Financave ka iniciuar rishikimin e kornizës afatmesme buxhetore 2021-2023 de qëllimi kryesor i rishikimit ka qenë adaptimi i prioriteteve të krijuara nga pandemia. Pas rishikimit të kësaj kornize buxhetore, ministria e financave ka lëshuar qarkoren e tretë buxhetore sipas së cilës është bërë shkurtimi i kufijve buxhetor për të gjitha organizatat buxhetore të vendit. Sipas kësaj qarkore për komunën e Klinës është caktuar buxheti 2021-2023 siç vijon: 2021- 10.658.263 euro. 2022- 12. 088,779 euro. 2023- 12.379, 827 euro. Pra për vitin 2021 buxheti i komunës sonë është shkurtuar për 395.877 euro. Për vitin 2022 është shkurtuar për 215.934 euro dhe për vitin 2023 është shkurtuar për 263.313 euro. Ky shkurtim është kryesisht në kategorinë e investimeve kapitale.

z. Fadil Gashi, kryesues i Kuvendit: Faleminderit Ajet Sejdiu. Të nderuar anëtarë ju e keni draft buxhetin e bashkë me draft buxhetin i keni edhe dy propozime. Caktimi i lartësisë së tatimit në pronë që sa herë që të miratohet buxheti duhet të miratohet edhe ajo dhe është një propozim lirim që ka ardhë nga komisioni për rimëkëmbje. Të dyja këto shkojnë bashkë me buxhetin dhe debatin që mund ta kemi. Më lejoni që të hap debat rreth buxhetit.

z. Isa Ibishi: Përshëndetje të gjithëve. Mendoj që ky është dokumenti më i rëndësishëm që ne si asamblistë është dashtë ta analizojmë dhe të përgatitemi sepse janë mjet të qytetarëve që kërkojnë kujdes. Dua të ndalem tek Urbanizmi. Së pari dua të jem korrekt me kolegët sepse që tre vite kam qenë korrekt, do të mundohem të kontribuoj për të mirën e përgjithshme që unë e mendoj. Vërejtjet e mija janë se projektet nuk janë specifikuar. Nuk dihet për cilën rrugë ku ka me u ndërtuar ajo rrugë sa ka me qenë e gjatë, kanalizimet po ashtu. Bashkëfinancim me donatorët- kush janë donatorët, nuk është specifiku. Shqetësim tjetër është ndarja e 30 mijë euro për ndërtimin e stacionit të autobusëve. Nuk e diji nëse ka ndonjë asamblist që mund të thotë se është në rregull heqja e tregut të gjelbër dhe dërgimi i tij tek shkollat. Janë shqetësime ë mijat pavarësisht se ndoshta nuk mund të bëjë asnjë ndryshim sepse ju i keni votat e diji që e kaloni këtë buxhet, por shqetësimet e tilla është dashtë të jenë edhe të pozitës. Stacionit të autobusëve duhet të i gjendet zgjidhje tjetër jo aty ku është përcaktuar. Tek Bujqësia po ashtu nuk është specifiku se në cilin vend do të ndërtohet kanalet e ujitjes, as nuk është definuar se sa gjatësi ka me pas ai kanal ujitje. Për mua nuk është në rregull as buxheti i ndarë për bujqësinë. Është dashtë të rritet ky buxhet për bujqësinë. Të investohen 200 mijë euro në rrugica për mua është e çuditshme. Më kuptoni drejtë, jam i predispozuar që ta mbështesë këtë buxhet por kjo formë kështu siç është nuk është në rregull. Unë kam problem që ta kuptoj edhe arsyen e thirrjes së seancës së

jashtëzakonshme nga LVV, po ashtu rendin e ditës së seancës së sotme, është për tu analizuar ky rend dite. I përmenda këto më idenë që të ju referoj që të kaloni nga improvizimet në realen. Nuk duhet improvizuar vetëm për vota sepse ajo vjen nëse keni punuar mirë. Mos të mendohet për votën dhe bazuar në të, të shkohet me projektet. Po më vjen keq që nuk është në këtë seancë shumë të rëndësishme as shefi i grupit kuvendar të PDK-së, sepse do të duhej të jemi kontribuues të kësaj pike. Unë deklaroj që vota ime në favor të këtij buxheti d të ishte nëse korrigjohet çështja e tregut të gjelbër-stacionit të autobusëve, specifikohet të gjitha projektet dhe e fundit që investimet e 2022 të kthehen në vitin 2021 për shtëpinë e të moshuarve.

z. Fadil Gashi, kryesues: Veç tek Rendi i Ditës të lutem kursena sepse ky rend dite është bërë në bashkëpunim me të gjithë shefat e grupeve të kuvendit.

z. Zenun Elezaj, kryetar Komune: Po filloj me shtëpinë e të moshuarve. Është shumë sfidë që të përgatisim për vitin e ardhshëm sepse kjo shtëpi është planifikuar me HZ tek ish parku i ish Malishganit. Aty ka nevojë për ndërhyrje si prishje objektesh, rregullim infrastrukture etj. prandaj e kemi vlerësuar se është vështirë të arrijmë brenda vitit të ardhshëm. Qëllimi është që të fillojmë vitin e ardhshëm dhe ta përfundojmë në 2022. Kur është fjala për stacionin e autobusëve dhe tregun e gjelbër, ne me Hartat Zonale e kemi aprovuar në ato lokacione, por unë pajtohem që duhet të punojmë ngushtë mes veti sepse unë duhet të sjell një vendim për zhvendosjen e tregut të gjelbër. Të flasim sipas përvojës dhe përshtypjes së marrë nga qytetarët, kjo rrugë realisht po ngulfatet shumë. Për këtë s'do të doja që të flas shumë pasi që sot e kemi vetëm aprovimin e buxhetit e ne mund të thërrasim seancë të jashtëzakonshme për këtë sepse nuk mund të bëhet zhvendosja e tregut të gjelbër pa vendimin e asamblesë. Është diskutuar edhe kur kemi aprovuar HZ, është diskutuar edhe për stacionin e autobusëve si nevojë e domosdoshme për qytetarët e Klinës. Për këtë çështje jemi të gatshëm që të punojmë ngushtë me të gjithë ju asamblistë dhe paraprkisht të përgatisim një propozim bashkërisht dhe nëse mendoni ju që nuk duhet të ndërtohet, nuk e ndërtojmë hiq, jeni ju ata që vendosni. Për investimet në rrugë që u përmend rruga Volljak-Sferkë, është fjala për renovimin e rrugëve ekzistuese, renovime që përfshijnë shtrimin e dy shtresave asfalt. Viti i kaluar por edhe ky vit, ku ka investime në asfaltimin e rrugëve të shkurtra me nga 50 metra e 100, është shumë e vështirë që të bëhen shumë kode me emërtime. Kjo praktikë ka qenë edhe në të kaluarën.

z. Arben Limanaj: Përshëndetje të gjithëve. Unë pata diçka vetëm te pjesa e projekteve kapitale për vitin 2021. Si asamblist vij nga ajo pjesë. E pashë tek projektet kapitale, kategoria e asfaltimit të rrugëve lokale në Caravik dhe në Cabiq. Nuk janë të përkufizime sepse është praktikë që të mos përkufizohen ato rrugica që mund të shtrohen me asfalt. Mirëpo nëse nuk është përcaktuar ekzekutivi, unë kam marr kërkesa nga banorët e asaj pjese për shtrim të rrugicave të cilat kanë mbet pa shtruar as edhe me zhavorr prej pas lufte. Nëse është mundësia unë i kam tri propozime të këtyre banorëve. Janë rrugica, nuk janë të gjata. Behët fjalë për dy rrugica në lagjen e Dakajve dhe dy rrugica në lagjen Ibishaj afër shkollës. Gjithashtu një kërkesë e

mësuesit Fazli Ferati ka ardhur për shtrim të një rruge 200 apo 300 metra që përfshinë disa shtëpia aty. Janë rrugë të nevojshme dhe janë kërkesa që janë bërë edhe në ekzekutiv. Gjithsesi jam porositë edhe unë si asamblist i asaj pjese. Kisha propozuar që këto tri rrugica të hynë në këtë pjesë të kategorisë së shtrimit me asfalt.

z. Fadil Gashi, kryesues: Duke e pasur mirëkuptimin edhe të kryetarit, ju ftoj që kushdo nga ju anëtarët e Kuvendit që keni kërkesa të tilla sikurse këto që i tha Arben Limanaj dhe Isa Ibishi më herët, konkretizoni si propozime dhe sjellin sepse kemi me mbajt seanca të tjera edhe në Tetor, Nëntor etj. Të dorëzohen këto kërkesa sepse kur të fillon përgatitja e projekteve këto kërkesa të jenë në drejtori. Pra, shuma po dihet për gjitha projektet, brenda asaj shumë mund të bëni propozimet dhe të i konkretizoni. Pas dorëzimit atëherë kemi kohë që ti ballafaqojmë argumentet për ndarjen dhe implementim.

z. Sefa Morina: Përshëndetje për të gjithë. Dua që të i drejtohem kryetarit të Komunës. Nuk e di ndoshta kohëve të fundit nuk kemi pasur ndonjë bashkëpunim të duhur. Unë kam kërkuar posaçërisht tek drejtori i Urbanizimit por nuk më ka marr parasysh kush asnjëherë që 20 vjet. Dua të dijë pak a shumë për mjetet se si do të shpërndahen në BL të Gllareves sepse kam disa kërkesa të kësaj natyre. Kërkesa tjetër është për lagjen Gjurgjevik. Fjala është për lagjen e Berishajve. Kam kërkuar që 15 vjet që të shtrohet ajo rrugë sepse ato familje as me makinë nuk mund të dalin dhe janë në gjendje shumë të rëndë ekonomike. Dëshiroj që në vitin 2021 të shtrohet kjo rrugë. Kemi edhe kanalizimin tek Hasanajt në fshatin Gllarevë. 20 shtëpi nuk kanë fare kanalizim aty. Kemi problemin në shkollën e Gllarevës, kaldajën e cila ka shpenzime marramendëse. Duhet patjetër ta ndërrojmë sepse s'ka pas nxehje historikisht. Nafta aty është avulluar, nuk ka ndodhë shpesh por ja që ndodhë ndonjëherë.

z. Zenun Elezi, kryetar i Komunës: Në kemi vonesa në procedura tenderimi sepse e dimë si ishte gjendja. Lirisht shko tek zyra e prokurimit dhe nëse has pengesa, jam unë që do të zgjidhi. Propozimet e asamblistëve do të shqyrtohen patjetër. Shkollës e Gllarevës ka hyrë këtë vit tek agjencioni i eficensës me një vlerë investuese deri në 200 mijë euro. Komplet nxehje e re, komplet sistem i ri dhe renovim komplet. Kemi nënshkruar memorandum mirëkuptimi dhe ata do të fillojnë të bëjnë projektin dhe sipas tyre punimet do të fillojnë në shkurt apo mars atëherë kur fillon dhe përmirësohet koha. Besoj që edhe lagja Hasanaj dhe për të tjera këtë vit tanimë është shpallë tenderi dhe këtë vit të gjitha rrugicat nëpër fshatra do të përfundojnë.

Znj. Saranda Elezaj: Kam propozimin që e pata më herët në fillim të kësaj seance e që u vendosë të diskutohet në këtë pikë. Në bazë të kompetencave të qeverisjes lokale, në veçanti të Kuvendit të Komunës, ne kërkojmë që të miratohet vendimi për ndihmë të fëmijëve të porsalindur si dhe nënave lehona. Kjo kosto prej 100 ose 150 eurove varësisht nga mundësitë buxhetore të ndahet si buxheti ose të gjendët ndonjë formë tjetër për ndarjen e këtyre mjeteve. Ky projekt ka gjetur zbatim në të paktën tre Komuna të Kosovës dhe besoj që do të gjejë edhe në Komunën tonë. Aprovimi i kësaj kërkesë

dhe implementimi i këtij projekti konsiderojmë se do të ketë impakt pozitiv në jetën e qytetarëve.

z. Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit Sarandë. Ne kemi biseduar bashkë për këtë projekt dhe jemi dakorduar të gjithë. Mendoj që duhet një analizë më e detajuar për shumat e caktuara etj. Është edhe kryetari këtu që mund të na ndihmoj.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Ne për këtë arsye kemi propozuar dhe parashikuar edhe rritjen e subvencioneve që ju e dëgjuat nga referuesi Ajet Sejdiu se Subvencionet për vitin e ardhshëm do të jenë 305 mijë euro. Ka pas një rritje graduale nga 65 mijë që kemi trashëguar vitin e parë tani do të kemi 305 mijë euro subvencione. Kam bërë përgatitjet për këtë projekt. Kemi numrin e lindjeve për vitin 2020 që është 210 lindje por na duhet një analizë më e mirë dhe në Kuvend duhet të vije shuma e propozuar. Sot propozoj që parimisht të pajtohemi që kjo të jetë pjesë e buxhetit e përfshirë në kategorinë e subvencioneve.

Znj. Saranda Elezaj: Faleminderit për bashkëpunimin kryetar. E kam pasë përkrahjen tuaj edhe kur e kemi diskutuar bashkërisht këtë projekt propozim.

z. Tush Dedaj: Përshëndetje për të gjithë. Mua më ka gjet sikurse ai tregimi për malsorin që i drejtohet kishës me fjalët: "oj kishë a nuk dita me tu lutë a nuk më more vesh", pasi që nuk ju kishin realizuar planet e bëra. E kam fjalën për rrugën për Dresnik që mendoj se është e çuditshme si me pasë farë lloj mallkimi pasi që nuk u shtrua kurrë. Kemi pritë në 2019 dhe nuk u bë, si duket as këtë vit nuk do të bëhet. E në vitin 2021 sipas kësaj që shkruan në këtë projekt buxhet, do të intervenohet në rrugën ekzistuese e cila është e shtruar asfalt e që në atë kohë kur është shtruar është bërë një segregacion pasi që rruga është shtruar vetëm deri në mes të dy lagjeve të Dresnikut. Tash pas 34 viteve po vjen puna me u shtrua e njëjta rrugë përsëri e kjo tjetra e shkreta për të cilën kam folur gjithmonë, ka mbet e pa trajtuar. Me e keqja është se rruga që vjen nga lumi, të cilën një ditë e kishte vizituar kryetari por që edhe pse ka kaluar nga dyert e mija nuk më ka thirr që të i bashkohem, kjo rrugë pra është e pa kaluar edhe sot. E keqja tjetër është së mbeturinat e lumit janë hedhë në rrugën që të qon tek pusi i Jarinës e që e kanë bllokuar totalisht. Po i drejtohem këtij Kuvendi pasi që po shihet se disa investime janë të përgjithësuara e nuk janë shumë precize, që mos të qitet shenja e barazimit në mes të qeverisë së viteve të 80-ta me qeveritë e pas luftës edhe pse mënyra e trajtimit po ja qet shenjen e barazimit. U fol për kanalet e ujitjes. Kanalet e ujitjes në fshatin Dresnik përpara kanë qenë nga 15 km , kanale shtetërore quheshin. Sot këto kanale janë të shkatërruara. Janë ndërtuar rrugë private që i kanë mbyllë këto kanale dhe askush nuk ka shkuar me i pa se a janë ndërtuar qysh duhet. Ju kam thënë edhe në seancën e kaluar, po jua them edhe tani. Për këta dy muaj unë e kam amortizuar qëllimin e futjes së një pengese(rampe siç thotë folësi). Për hatër të qytetit të vjetër është dashur të shtrohet rruga deri tek gjurmimet dhe zbulimet arkeologjike. Ju faleminderit për durimin por do të doja që Dresniku të mos mbetet kështu qysh është i egër.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Për Dresnik kemi dhënë shpjegime të herë pas herëshme. Gjithçka lidhet për një projekt që e ka vlerën e ndarë prej 600 mijë euro. Ka neglizhencë nga Ministria por jam i sigurt se s' kanë nga të shkojnë disa procese. Atë ditë në Dresnik kam qenë me kërkesën e dy tre banorëve në një lagje në Dresnik. Pajtohem që ndoshta për shkak të nxitimit nuk të kam thirr që të na bashkoheshe, por kjo s' do të thotë që nuk jam i gatshëm që ti diskutojmë në çdo kohë këto probleme. Unë kam një propozim konkrete. Buxheti komunal që ka vlerën prej 200 mijë euro e që ka edhe buxhet tjetër, të i shtohet vetëm një vizë dhe të shkruhet: Klinë-Dresnik. Në mënyrë që ta kem të drejtën nga ju që nëse nuk fillojnë punimet nga ministria deri në pranverë e vitit të ardhshëm, unë të kem të drejtën që komplet këtë buxhet ta orientoj në atë drejtim.

z. Tush Dedaj: Kemi diskutuar, z. Kryetar, për këtë punë. Duhet pak kujdes edhe për ne sepse edhe ne paguajmë tatimet, edhe ne jemi Kosovë. Kam pasë dëshirë që sa më shpejt të kryhet kjo rrugë sepse po lindin llafe jo të këndshme. Kur ta qesim "rampën" ne, atëherë vijnë edhe gazetarë të ndryshëm dhe lindin edhe llafe të ndryshme. Kjo rrugë është dashur që të rregullohet në vitin 2000 e jo tani në 2020.

z. Azdren Ramadani: Përshëndetje për të gjithë. Unë e mbështes kolegun tim Isa Ibishi për atë që foli por unë dua ë ndalem tek kultura. Në Draft Buxhet e shoh që janë të ndara 20 mijë euro, ku janë të ndara këto dhe për çfarë. Si asamblist kam marrë disa kërkesa nga bashkëfshatarë të mijë. Në fshatin Drenoc të rregullohet ujësjellësi dhe rregullimi i rrugëve lokale me asfalt. Në fshatin Rastokë, kanalet e ujitjes dhe urës për këmbësorë, ndërsa në fshatin Çeskovë të futet projekti për rregullimin e kanalizimit të ujërave të zeza.

z. Tunë Dedaj: Përshëndetje për të gjithë. Rreth buxhetit komunal 2021-2023, falënderoj ë gjithë ata që e kanë hartuar këtë buxhet sepse është gjithëpërfshirës. Pajtohem plotësisht me z. Tush për Dresnik sepse ka mbetur shumë keq por rruga për të cilën foli nuk ka mbetur e tillë nga neglizhenca e kryetarit por të Ministrisë. Prandaj dua të falënderoj kryetarin për ato 200 mijë euro që i propozoj të bëhet shtesë në emërtim.

Znj. Elvira Sejdiu: Përshëndetje për të gjithë. Në qytetin tonë mendoj që prioritet është edhe çështja parkingut. Këtë mungesë të parkingjeve po e ndiejnë qytetarët e në veçanti banorët e banesave. Rregullimi i këtyre parkingjeve do të ndikonte në rregullimin urban të qytetit. Shpresoj që kjo çështje të mos mbetet në nivel debatesh por të jetë prioritet për qytetarët e Klinës. Tek investimet e arsimit. Unë propozoj që për vitin 2021-2022 të bëhet hapja e paraleleve parashkollore në shkollat e fshatrave të Komunës sonë. Kjo do të krijonte mundësinë e edukimit të hershëm të fëmijëve. Nëse nuk është mundësia në të gjitha shkollat, atëherë të fillohet me 5 apo 6 shkolla fillimisht për të rritur numrin në vitet në vazhdim. Është diskutuar shumë për rrugicat nëpër fshatra. Unë mendoj që Klina akoma nuk i ka të shtruar të gjitha rrugicat në Klinë. Besoj shumë dhe shpresoj që çdo rrugicë e Klinës të jetë e shtruar me asfalt. E kam diskutuar edhe më parë rrugën që mban emrin e dëshmorit Ilaz Gashi. Që sa vite ajo

rrugë mbetët e pa asfaltuar. Shpresoj që edhe kjo të rregullohet këtë vit sikurse edhe të gjitha rrugicat e tjera të qytetit.

z. Isa Ibishi: Unë dua të shikoj mundësinë dhe vullnetin dhe do të tërhiqem nga kërkesa ime për shtëpinë e të moshuarve kërkuar nga unë që të bëhet për 2021. Mbetëm pranë dy kërkesave të më hershme. Të specifikohen projektet se ku kanë për tu ndërtuar dhe e dyta që kryetari të zotohet publikisht që për tregun e gjelbër të shikohet mundësia të mos lëvizet nga aty ku është. Këto dy kërkesa i kam, mendoj që janë të mira dhe në interes të përgjithshëm. Po më intereson vullneti i Opozitës se a ekziston, nuk është më rendësi vota ime pasi që vota keni të mjaftueshme.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Asdreni që pyeti për kulturën. Bëhet fjalë për 30 mijë euro. 20 mijë euro do të ndërtohet një fushë e tenisit tek fusha ndihmëse dhe 10 mijë euro janë destinuara për rregullimin e kullës së Mujë Krasniqit. Për Elvirën: Nuk do të mbetët asnjë rrugicë në qytet pa asfaltuar. Për tregun, ne nuk mund ta zhvendosim tregun pa e diskutuar këtu në asamble dhe një herë. Ndoshta duhet të thërrasim seancë të jashtëzakonshme për këtë punë. Jam i gatshëm që intezivisht ta diskutojmë këtë modalitet. Kjo do të jetë pikë e veçantë e Kuvendit në një nga seancat e ardhshme.

z. Xhevxhet Berisha: Përshëndetje për të gjithë. Do të doja të përshëndes drejtor për shpërndarjen e mirë të buxhetit dhe gjithëpërfshirëse. Do të doja që për vitin 2021 të i kushtohet kujdes të veçantë kanalizimit të ujërave të zeza në fshatin Sferkë. Pastaj, planifikimin për vitin 2021 të rrugëve në Komunën e Klinës. Kërkoj nga drejtori Lorenc që në projekt të përfshihen edhe hapja e pusetave për arsye se këto puseta nëpër rrugë janë të mbuluara. Dhe e fundit, një vërejtje për ne asamblistët që nganjëherë po vonohemi në paraqitjen e kërkesave në afatin e duhur.

z. Fadil Gashi, kryesues: Ne vitin e kaluar e kemi votuar një buxhet për tre vite, sikurse ky që është tani për tre vite dhe nëse i referoheni ka projekte të miratuara në këtë kuvend dhe që janë të bartura. Kemi kornizën buxhetore dhe dëgjimin publik të mbajtur në kushte pandemie. Kemi bërë shqyrtime edhe në KPF, pra jemi munduar që ti shterojmë të gjitha mundësitë. Kjo procedurë ka qenë e tillë prej që është themeluar Kuvendi. Gjithsesi në fund është përcaktuar një afat kohor që është 30 shtatori kur duhet miratuar buxheti. Mendoj që krejt këto propozime të thëna sot këtu, të shndërrohen në kërkesa me shkrim dhe të dërgohen në drejtoritë përkatëse në mënyrë që edhe këto propozime të bëhen pjesë e buxhetit.

z. Isa Ibishi: Më ka ikur pa e theksuar. Më bëri përshtypje se në draft shkruan autoambulancë mjekësore- 90 mijë euro. A bëhet fjalë për një apo dy? (merr përgjigjen se bëhet fjalë për dy autoambulanca)

pasi që nuk kishte të interesuar të tjerë për debat, kryesuesi duke konstatuar se prezent në kuvend janë 19 anëtarë, ai e hodhi në votim projekt buxhetin për vitin 2021-2023 dhe me 15 vota për, asnjë kundër dhe një abstenim, u MIRATUA.

Pika 5 e Rendit të Ditës: Propozim – vendim ër emërtimit të sheshit të ri me emrin e ish presidentit Ibrahim Rugova.

Kryesuesi sqaroi se bëhet fjalë për rrugën nga qendra në drejtim të stacionit të trenit, ku mendohet ë bëhet një rethrrrotullim .

Znj. Violeta Zefaj: Faleminderit kryesues. Përshëndetje për të gjithë. Siç e thatë edhe ju, ne e kemi bërë një propozim në emër të grupi dhe prap siç e thatë edhe ju, në dakordim të plotë me të gjithë partnerët e tjerë, ndonëse figura e presidentit historik Ibrahim Rugova nuk ka nevojë për arsyetim, ne vlersojmë se emrimi i një sheshi të Ri me emrin e presidentit do të pasuronte listën e shesheve në qytetin e Klinës. Kështu që ju ftojme të gjithëve që ta mbështesni kërkesën tonë. Kaq, faleminderit.

z. Petrit Palushaj: Ne si grup kuvendar e kemi diskutuar këtë pikë dhe vota jonë do të jetë për. Mendoj që ky propozim as që do të duhej të diskutohej.

Znj. Elvira Sejdiu: E përkrahi propozimin për emrin e sheshit Ibrahim Rugova. Jam e lumtur që sot kam nderin ta votoj PËR atë rreth rrotullim që do ti vihet emri i Ibrahim Rugovës.

z. Xhevxhet Berisha: Edhe ne si grup e përkrahim që një shesh të emërohet me emrin Ibrahim Rugova dhe shpresoj që nuk bëhet praktikë që edhe për presidentët e tjerë të veprohet kështu.

Me vota unanim (20) u Miratua

Pika 6. E Rendit të Ditës: Propozim-vendimi për emërimin e ish parkut Malishgani me emrin e heroit ë Kosovës , Ilir Merturi.

Kryesuesi theksoi se kjo kërkesë është bërë nga prindi dëshmorit dhe se ky kërkesë është analizuar në KPF dhe ka kaluar. Hap debat.

Znj. Mende hije Duraku: Të nderuar të pranishëm. Më lejoni të bëjë një sqarim të vogël në këtë pikë. Me shumë respekt për familjen e dëshmorit Ilir Merturi dhe të gjitha familjet e dëshmorëve, por dua ta vë në pah mënyrën se si familja i është drejtuar Komunës. Sipas përmbajtjes së kësaj kërkesë rezulton se qyteti ynë i Klinës ka vetëm një dëshmor. Kjo nuk është e vërtetë sepse Klina ka edhe dëshmorë të tjerë. Ne nuk guxojmë të bëjmë dallime e as injorim të dëshmorëve sepse të gjithë kanë rënë për këtë tokë. Thënë të vërtetën, ky formulim i kësaj kërkesë me qellim ose pa qellim, mua më ka shqetësuar dhe më ka bërë të ndjehem shumë keq. Besoj që do të ndjehen keq edhe familjarët e tjerë të dëshmorëve të Kombit. Uroj që në të ardhmen të mos na ndodhin gjera të tilla ë pakëndshme çoftë me ndonjë tendencë apo nga mos njohja e realitetit. Lidhur me kërkesën e babit të dëshmorit Ilir Mërturi për emërtimin e parkut me emrin e dëshmorit, vota ime do të jetë PRO.

Z. Fadil Gashi, kryesues: Unë jam dakord me atë që e fole, Mende hije. E kemi debatuar këtë kërkesë dhe jemi pajtuar që nuk është e mirë ajo që e ka shkruar prindi i dëshmorit Ilir Merturi. Kam biseduar edhe me familjarët dhe është konstatuar se nuk ka pasur

qëllim të caktuar. Unë e kam pasur bashkëlloftëtar Ilir Mërturin, kam obligim moral ndaj tij por nuk është dëshmor i vetëm në qytetin e Klinës të gjithë e dimë këtë. Prandaj mos e kuptoni si të qëllimshëm gabimin e bërë. Miqësisht po ju kërkoj që kur është në pyetje emri i një dëshmor i të mos ndahemi.

z. Petrit Palushaj: Meqenëse është një pikë e ndjeshme dhe ka të bëjë me emrin e një dëshmor siç është Ilir Mërturi, me gjithë respektin e madh për gjakun e derdhur të tij dhe kontributin familjar, ne si qytetarë të Klinës e dimë që kemi shumë dëshmorë dhe nuk guxojmë të bëjmë asnjë lloj dallimi duke ngritur në rang krahasimi se cili është më i lartë e cili më poshtë shkaku se të gjithë dëshmorët kanë vdekur nga i njëjti okupator dhe për të njëjtin qëllim. Kemi edhe dëshmorë të tjerë nga qyteti i Klinës, siç është dëshmor i Leonard Palucaj, familja e të cilit kohë të gjatë ma kanë thënë dhe kërkuar që një shesh të mban emrin e tij ose një shtatore të ngritet në qytet. Shpresoj që në emërtimet e tjera që financohen nga Komuna, të jetë edhe emri i dëshmorit Leonard Palucaj. Vota e grupit tonë Kuvendar do të jetë për emërimin e parkut me emrin e Ilir Mërturit.

z. Esat Raci: Pa u konsultuar fare me asamblisten nga radhët e partisë time, sa i përket propozimit për të cilin po flitet, unë do ta jap votën time Për dëshmorin, Ilir Mërturi.

z. Xhevdet Berisha: Edhe ne si grup kuvendar e përkrahim emërimin e parkut në fjalë me emrin e dëshmorit Ilir Mërturi.

Kryesuesi e vuri në votim dhe me vota unanim, d.m.th., pa asnjë abstenim dhe pa asnjë kundër u MIRATUA që ish parku "Malishgan" tani e tutje të mban emrin e dëshmorit Ilir Mërturi.

Pika 7 e Rendit të Ditës: Propozim –Vendim për vendosjen e bustit të veprimtarit Anton Çeta

Kryesuesi theksoi se kemi marr një kërkesë nga forumi intelektual i Klinës për vendosjen e një busti për veprimtarin e madh të çështjes Kombëtare, Anotn Çeta në qytetin e Klinës. Anën financiare e bartin vet propozuesit. Kërkesa e tyre është për një lokacion. Forumi i Intelektualëve pajtohen me cilin do variant për hapësirë që ne të vendosim. Ideja e jonë- imja dhe kryetarit është për bazamentin e ndërtuar tek sheshi "Nënë Tereza", që edhe pse pronësia e asaj pjese është diskutabile, besoj që me vendimin e Qeverisë ajo do të bëhet pronë e Komunës. Qëllimi është që ne si kuvend të pajtohemi në parim për plotësimin e kësaj kërkesë dhe më pastaj zgjedhja e lokacionit është e lehtë.

z. Tush Dedaj: Unë jam pro dhe nuk kam asnjë gjë kundër. Por më duket që kjo vendosja e busteve po bëhet Bustomani. Më mirë do të ishte që emrin e Anton Çeta të i vendoset një shkollë apo një institucioni. Për vendosjen e bustit ë Gjergj Kastriotit, askush nuk më ka pyet. Vendi ku është vendosë ky bust mendoj që nuk është hiq dinjitoz. Ndoshta më mirë është që të caktohet një lokacion më i madh dhe aty të vendosen bustet e personaliteteve.

Znj. Violeta Zefi: Kjo kërkesë ka kaluar edhe në KPF. Unë personalisht e mbështes jashtëzakonisht shumë kërkesën e forumit të intelektualëve. Për profesor Anton Çeta sado që të flasësh është pak dhe bazuar në këtë mendoj se është e turpshme që niveli qendror nuk i ka dhënë vendin e merituar deri me tani profesorit Anton. Votimi PRO kësaj kërkesë mendoj që është një kontribut modest i yni karshi figurës së nderuar të profesorit Anton Çeta.

z. Petrit Palushaj: Këtë kërkesë e kemi diskutuar ë grupin tonë kuvendar dhe ne si grup kuvendar e përkrahim këtë kërkesë.

Kryesuesi e vuri ë votim dhe pa asnjë kundër dhe asnjë abstenim u MIRATUA.

Pika 8 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i plotësimit të draft rregullores për bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Klinës.

Kryesuesi theksoi se ky draft rregullore i ka kaluar të gjitha shqyrtimet e nevojshme të përcaktuara me ligj, dhe për prezantimin e saj e ftoj që ta merr fjalën kryetarin e komisionit , z. Binak Sylaj.

z. Binak Sylaj, drejtor i Administratës: Përshëndetje për të gjithë. Siç e tha edhe kryesuesi, në bashkëpunim me anëtarët e tjerë ë komisionit, kemi hartuar këtë plotësim ë draft rregullores në fjalë. Kemi konsultuar edhe zyrën ligjore dhe kemi marrë edhe përvijat e komunave të tjera. Është harmonizuar me ligjin ekzistues dhe është rregullore unike për të gjitha komuna e Kosovës. Ju e keni para vetës draftin dhe besoj që e keni analizuar. Ajo që kërkoj nga ju është që të shikoni mundësitë se ku mund të inkorporohen fshatrat në këta 20 këshilla lokal, nëse ne nuk e kemi bërë drejtë ndarjen. Klina si qytet i ka 4 lagje urbane dhe kemi paraparë 4 këshilla lokal si dhe 16 këshilla të tjerë nëpër fshatra. Nëse keni ndonjë pyetje apo sugjerim jam këtu që të përgjigjem.

z. Fadil Gashi, kryesues: Atë që e tha drejtori është mirë të implementohet sepse kur të del në teren komisioni, haset në pengesa. Kjo rregullore po ndryshohet për shkak ë unifikimit në nivel të Republikës së Kosovës. Të gjitha Komuna e kanë draftin unik, përveç numrit ë këshillave që përcaktohet në bazë të numrit të banorëve. (hapet debat)

pasi që nuk e mori fjalën asnjëri nga anëtarët e Kuvendit për të debatuar, kryesuesi e vuri në votim dhe me vota unanime u MIRATUA Rregullorja për bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Klinës.

Pika 9 e Rendit të Ditës: Formimi i Komisionin për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave

Kryesuesi theksoi se çelësi është i përbërë nga 7 anëtarë. 4 nga Kuvendi, 1 nga ekzekutivi, 1 nga shoqëria civile dhe 1 nga secili lokalitet ku shkohet për të zgjedhur këshillin, e zgjedhë vet komuniteti.

U propozuan: 1. Petrit Palushaj, 2. Sefa Morina, 3. Enver Berisha, 4. Brahim Mehmetaj, 5. Shoqëria civile, 6. Binak Sylaj, 7. komuniteti i lokalitetit.

Propozimet u vendose në votim dhe me vota unanim u MIRATUA.

Pika 10 e Rendit të Ditës: Inicimi për hartimin e Draft Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës.

Kryesuesi theksoi se ne si kuvend kemi me marrë vendim vetëm për iniciimin për hartim, ndërkaq shqyrtimi i kësaj rregulloreje do të na vije në seancat e radhës.

Ky iniciim u vendos në votim dhe me vota unanim të të gjithë anëtarëve të Kuvendit u MIRATUA.

Pika 11 e Rendit të Ditës: Inicimi i hartimit të Draft Kodit të Etikës

Edhe në këtë pikë të rendit të ditës nuk kishte të interesuar për debat prandaj kryesuesi e vuri në votim dhe me vota unanim të të gjithë anëtarëve të Kuvendit u MIRATUA.

Pika 12 e Rendit të Ditës: Rishqyrtimi i Vendimit nr. 06 15082/2020

Kryesuesi theksoi se ky është një vendim që e ka marr Kuvendi i Komunës dhe sipas shkresës së MAPL ka kërkuar që të rishikojmë vendimin tonë. Unë me mirëkuptimin tuaj dua të shpalosë krejt rrjedhën. Jemi para dy alternativave: Të anulojmë vendimin tonë por edhe të mos e anulojmë sepse nuk na obligon askush, jemi të obliguar që ta rishqyrtojmë. Rrjedhja e ngjarjeve është kur janë lëshuar pëlqimet nga drejtoria e Urbanizimit. Me datë 5 mars 2020 kemi shqyrtuar në një seancë të jashtëzakonshme një petition të qytetarëve dhe kemi dalë në mbështetje të atij peticioni. Më vonë nga MPAL me datë 24 mars e kemi pranuar njoftimin. Me 5 qershor kemi pranuar shkresën tjetër të MAPL që na njofton se vendimi i datës 5 mars 2020 është dërguar për vlerësim në ministri të linjës. Në seancën e rregull me datë 26 qershor, jemi dakorduar që ta përmirësojmë vendimin e parë dhe ja kemi hequr vetëm pikën 3 të atij vendimi. Po të njëjtën ditë e kam njoftuar personalisht KPMM dhe drejtorin Ramiz Krasniqi edhe me vendimin edhe me arsyetimin. Me datë 28. 07. 2020 kemi marr nga MAPL një raport të ligjshmërisë për këtë dhe na kanë njoftuar që për vlerësim të ligjshmërisë MAPL e ka dërguar në KPMM që është skandali më i madh pasi që KPMM nuk ka kompetencë për vlerësim të ligjshmërisë së vendimeve të Kuvendit. Unë kam pas një takim me përfaqësues të MAPL dhe ata nuk janë shumë në rrjedha të kësaj. Me dt. 03. 08. 2020, kompania veç se i ka marr licencat për veprimtari. Kompania në fakt pëlqimet nga drejtoria e urbanizimit në Klinë kompania Ëallingford i ka marr për nxjerrjen e gurit gëlqeror dhe karbonik, por interesant është se në rast të kontesteve pronësore me persona fizik ose juridik, komuna e Klinës do ta anuloi këtë vendim, thotë drejtoria e urbanizimit në pëlqimin e dhënë. Ndërsa kjo drejtori e ka një Kuvend të Komunës që e ka marr një vendim për anulim të pëlqimeve por se drejtoria nuk e ka respektuar. Pra drejtoria vet mund ta anuloi pëlqimin e dhënë ndërsa kur të ja kërkon kuvendi nuk mundet. Këto janë çështje që na qesin në dilema të mëdha kur i referohemi licencave

që i ka marr kompania Ëallingford, e që janë tri licenca me datë 03. 08. 2020 me afat prej 25 vjetëve.

Tani pak në lidhje me shkresën që e kemi marr nga Ministria dhe KPMM që ka kërkuar të bëjmë anulimin e vendimit të marrë nga ne si Kuvend: Interesant, thonë se kemi rënë ndesh me strategjinë minerare që aprovohet në Kuvendin e Kosovës. E kam sqaruar edhe me Ministrinë. Ne nuk kemi telashe as me Ministrinë as me Strategjinë Minerare as me KPMM. Nuk kemi rënë ndesh me asnjërën nga këto. Ne kemi telashe me drejtorinë tonë, kësaj drejtorie ju kemi drejtuar që ti tërheq pëlqimet. Ligji për Administrimin e Pushtetit Lokal njih dy organe. Organin e Kuvendit që është legjislativ dhe është organi më i lartë përfaqësues dhe vendim marrës dhe Ekzekutivin në krye më kryetarin e Komunës dhe drejtoritë që ekzekutojnë vendimet. Që nuk kemi rënë ndesh as me Ministrinë dhe as me KPMM, tashmë janë të bindur edhe ata. Unë dje i kam pasur në takim edhe përfaqësuesit e peticionit qytetarë. Qytetarët që kanë nënshkruar peticionin sot kanë pasë me u mbledhë këtu para Komune por unë nuk i kam lënë duke jua shpjeguar se nuk është e nevojshme pasi që kjo lëndë është në procedura e edhe në duart e organeve hetuese. Në fakt, dje më kanë informuar zyrtarisht organet kompetente se kjo lëndë është në prokurori. Gjitha këto që i thash janë të dokumentuara me fakte e dokumente. Ju e dini që janë mbi 4000 nënshkrues të peticionit dhe tani është në dorën tuaj të vendosni nëse doni të jeni në krahë me qytetarët që kanë nënshkruar peticionin dhe vendimit që kemi marrë apo kundër. Unë jam që të qëndrojmë pranë vendimit tonë të marrë dhe ju them që kam dëshirë që të merrem me organet e drejtësisë për këtë rast. Për momentin nuk kam më shumë për të shtuar. Po hap debat për këtë temë.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Nuk dëshiroj që të bëjë kronologji të kësaj teme, besoj që jemi të gjithë në ngjarje. Por, është një fakt i rëndësishëm: A ka hy në fuqi ai Vendim apo jo? Për mua si kryetar dhe për drejtorinë e Urbanizmit është më rëndësi që Asambleja Komunale atë vendim ta fus në fuqi. Në çdo kohë që zyra ligjore na sjell një shkresë që ka hy në fuqi, natyrisht që Ekzekutivi s' ka qare pa e respektuar.

z. Fadil Gashi, kryesues: Ne me kryetarin këtu nuk jemi në gjykatë. Ministria nuk i referohet Vendimit të parë por vendimit të fundit, këtë që kemi heq pikën e 3 nga ai vendim. Pra ne sot nëse marrim vendim që ta anulojmë vendimin sipas kërkesës së Ministrisë e cila ka dhënë shënime si nr. Protokolli e datë për vendimin që kërkojnë anulim, ne e anulojmë vetëm vendimin e dytë, këtë pa pikën e tretë e jo edhe vendimin e 5 marsit. Këtë e kemi sqaruar edhe me zyrën ligjore. Tjetër, kryetar, ne si kuvend kemi kërkuar nga drejtoria e jonë që të i tërheq pëlqimet, nuk kemi kërkuar nga institucionet e tjera. Por, nëse i referohemi shkresës zyrtare të KPMM-së, nuk e di kush ja ka përgatit por vetëm jurist nuk ka qenë. Aty shkruan kështu: KPMM ka lëshuar një numër të madh të licencave për shfrytëzimin e minierave në zonën e Gremnikut dhe Dollcit, për të cilat janë lëshuar edhe Pëlqimet Komunale të Klinës. Anulimi i të gjitha pëlqimeve do të rezultonte me anulimin e të gjitha këtyre licencave të lëshuara në mënyrë të ligjshme dhe do të shkaktohte pasoja juridike dhe dëme të mëdha ekonomike

për ndërmarrjet e pajisura me licencë dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. Si rast konkret KPMM e përmend rastin e Telekomit e që ne në fakt nuk kemi ngjashmëri fare me Telekom. Për mua kjo është më shumë çështje e brendshme e Komunës. Tani se a e implementon apo jo drejtoria, në të dy rastet besoj që të gjithë kemi me përfunduar në gjykatë sepse kemi prodhuar një akt juridik. Unë kam dëshirë që kështu të ndodhë. Të ballafaqohemi në gjykatë edhe ne, edhe drejtori i Urbanizimit por edhe Ministria. Nuk mundemi ne me i sqaruar këto vendime e veprime. Kuvendi s'kam qef me ranë lajthitje. Të dihet se ne si kuvend kemi prodhuar dokumente juridike, ato dokumente kanë prodhuar efekte juridike dhe kanë me përfunduar në gjykatë.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Pse ka mbetur rregull që çdo vendim i asamblesë të dërgohet në Ministri për ligjshmëri. Dhe se pa u kthye vlerësimi i ligjshmërisë së vendimit të Kuvendit ai nuk mund të hyjë në fuqi. Ose është procedura tjetër sipas rregullores që duhet të pritët 15 ditë pas dërgimit të vendimit në Ministri dhe pas 15 ditëve të mos kthimit të përgjigjes nga Ministria, vendimi hyn në fuqi. Pra janë procedura që ne s' kemi rrugë tjetër përveç se me i respektuar. Mendoj që pa të drejt po gjuhet faji tek Ekzekutivi Pa asnjë diskutim në momentin që të kthehet ligjshmëria e vendimit tuaj, ne bashkë me zyrën ligjore do të marrim veprimet e duhura që ai vendim të implementohet menjëherë. Po thuhet se vendimi i marr prodhon efekte juridike. Unë nuk kam pa shkresë që thotë se vendimi i marr prodhon efekte juridike.

z. Fadil Gashi, kryesues: Më së shumti kemi fol me kryetarin për këtë çështje kur nuk keni qenë ju dhe prap më së shumti po flas me kryetarin kur jeni ju. Kryetar, nëse nuk ka një shkresë nga Ministria që thotë se vendimi i juaj prodhon efekte juridike, gjithashtu nuk ka një shkresë që thotë se Vendimi i juaj nuk prodhon efekte juridike. Unë mendoj që fajin e ka vetëm drejtoria e urbanizimit që i ka leshu ato pëlqime. Këtë nuk po e them vetëm unë, ka për ta thënë edhe dikush tjetër. Nëse i referohemi vetëm Pëlqimit, ja çfarë thotë drejtoria e Urbanizimit: Pasi që patundshmëria e kërkuar nga pala nuk është në pronë komunale, por më këtë menaxhon Agjencioni Pyjor i Kosovës, i cili edhe ka të drejtë që ta jep në shfrytëzim këtë parcelë, Komuna vendosë që ta lëshoj këtë pëlqim me përmbajtjen e cekur më lartë. Prandaj ne kemi thënë që drejtoria le ti tërheq pëlqimet e veta. Nuk kemi kërkuar as nga Ministria as nga KPMM. Vetëm drejtorinë në fjalë e kemi telashe ne. Vendimi i jonë ju ka drejtuar vetëm drejtorisë përkatëse.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Kryesues, është dashur që të ndiqet procedura. Brenda 15 ditëve ë mungesës së përgjigjes nga Ministria, të shpallet në ëeb të Komunës dhe sipas ligit të pritët 7 ditë apo si është e rregulluar kjo. Dhe më pastaj ai vendim të hynë në fuqi. Mendoj që s'kemi çka diskutojmë për këtë problem. Mjafton të hy në fuqi dokumenti dhe ne e implementojmë. Ju keni pasur të drejtën që ta fusni në fuqi atë vendim i cili nuk ka përfunduar nga ana e Kuvendit të Komunës.

z. Fadil Gashi, kryesues: Kryetar. Vendimet e Kuvendit të Komunës, Kuvendi asnjëherë nuk i publikon në ëeb faqe zyrtare të Komunës. Mos të krijohet përshtypja që Kuvendi e ka pasur obligim këtë punë. Jo pa qellim shkruan në fund të vendimit që merr kuvendi: Të njoftohen, MAPL, Drejtoria e Urbanizimit, kryetari i Komunës dhe Arkivi. Këtu

përfundon puna e Kuvendit me nënshkrim timin në fund. Më pastaj ne si kuvend nuk kemi qasje të mëtutjeshme në dokument dhe procedura.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Kryesues, ty të ka informuar MAPL se vendimin e kuvendit e ka dërguar në ministri të linjës për shqyrtim të ligjshmërisë. Këtë të gjithë e kuptojnë çfarë do të thotë. Të ka informuar se nuk duhet të marrësh veprime në drejtim të implementimit të vendimit derisa ta kthejnë vlerësimin pavarësisht afatit kohorë. Po mundohem të tregoj edhe për opinionin e gjerë edhe për anëtarë të Kuvendit se veprimet tona duhet të i nënshtrohen ligjeve të Kosovës.

z. Fadil Gashi, kryesues: Ok, unë nuk po e zgjatë më shumë. Këtë lëndë tani më e ka prokurori dhe besoj që edhe me përfaqësuesit e Ministrisë do të takohemi. Po hap debat për anëtarët e Kuvendit.

z. Xhevxhet Berisha: Këto situata spo di qysh me i analizuar. Pak me driblime, pak me të ngecmë. Do të doja që zyra ligjore bashkë me kryesuesin dhe kryetarin që menjëherë të përgatisin kallximin për falsifikimin e procesverbalit të mbajtur nga debati me qytetarë që Kompania dhe MAPL e kanë mbajtur. E kanë vajtuar pagesën e madhe për Bechtel enka, e kanë vajtuar Telekomin, tash e vajtojnë Komunën e Klinës. Përfundimisht qëndroj pranë propozimit për ngritje të kallximit penal dhe në asnjë mënyrë anulim të vendimit tonë. Pse nuk është njoftuar me kohë KPMM për vendimin tonë, këtë e dijnë akterët përgjegjës. Flas në emrin tim personal dhe besoj që edhe grupi im kuvendar më përkrahë: vendimi i jonë i marrë për anulimin e të gjitha pëlqimeve të dhanë të mbetet në fuqi. Dhe të shihemi në gjyq nëse është e nevojshme.

z. Tunë Dedaj: Gjithmonë e kam vërejtë që ne i marrim disa vendime pa e konsultuar zyrën ligjore. Ose nëse zyra ligjore na këshillon që të marrim një vendim jo të mirë atëherë pse është zyra ligjore.

Me kërkesën e asamblistit Tunë Dedaj dhe të kryesuesit, zyra ligjore, shefi i zyrës, z. Ali Shala morri fjalën dhe interpretoj këtë çështje gjithmonë duke u ankuar se vetëm kur po bëhet goxha vonë po i drejtoheni zyrës ligjore. Z. Shala përmendi rastin e para disa viteve kur nuk i është dhënë pëlqim nga Komuna kompanisë Sharrcem dhe se si kompania e ka paditë Komunën e Klinës e që Komuna ka fituar. Pas tërheqjes së padisë së Sharrcem atë kohë, pa dijeninë e zyrës ligjore të njëjtës kompani ju ka lëshuar një pëlqim Komunal, për të cilin pëlqim zyra ligjore nuk ka dijeni. Zyrtari ligjor theksoi se kompania tash Ealingford është dashtë të ketë marrëveshjen me titullarin e pronës. Pa pëlqimin e titullarit të pronës nuk a as veprime adekuate, sepse toka nuk ka qenë publike Komunale por e një titullari tjetër. Këtu situata ka humbur në hapa. Pëlqimi i komunitetit, marrëveshja për çasje në pronë dhe pëlqimi i drejtorisë së urbanizimit janë akte të njëkohësishme, theksoi z. Shala dhe vazhdoi më tutje me përgjigje në pyetjet e anëtarëve të kuvendit si dhe të kryetarit e kryesuesit.

Kryetari i Komunës, z. Elezaj ndërhyri duke thënë se autoritet licencues është rregullatori i minierave e jo Komuna. Komuna e jep një pëlqim i cili nënkupton: A është në harmoni me politikat zhvillimore Komunale. Pra, nuk lëshon licencë. Vërtetë nuk

është pronë e komunës ajo pjesë por ne lëshojmë siç e thash pëlqim vetëm sa i përket politikave zhvillimore të Komunës. Kryetari i komunës insistoj të merr përgjegjë nga shefi i zyrës ligjore se kur komuna duhet të i tërheq pëlqimet e dhëna dhe përgjigja definitive e z. Ali Shala ishte se Komuna duhet të i tërheq pëlqimet e dhënë atëherë kur të kthehet ligjshmëria e vendimit nga MAPL.

Debati u zhvillua në formë interaktive në vazhdim. U angazhuan anëtarët e kuvendit, z. Xhevxhet Berisah, z. Isa Ibishi, kryesuesi z. Fadil Gashi, kryetari Elezaj, etj. Në fund të debatit Kryesuesi e vuri në votim : Me 12 vota PËR, asnjë kundër dhe 3 abstenime, u MIRATUA që të mos anulohet vendimi i marrë i kuvendit me nr. 01Nr.06-15082/2020 i datës 02. 07. 2020

Pika 13 e Rendit të Ditës: Propozim – Vendimi për tërheqjen e ankesës nga DKA për pagesat e arsimtarëve.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Në momentin kur e kërkoja sqarimin dhe bazën e gjeta tek procesverballi i kaluar. Propozimi është që drejtori i DKA të tërheq ankesën sepse ajo prodhon vetëm efekt negativ. Sipas të gjitha këshillave ligjore, inspektorati e ka marr vendimin prandaj nëse bëjmë ankesë do të krijojmë shpenzime shtesë për ti paguar kryesisht ata që e mbrojnë kërkesën e arsimtarëve dhe jo arsimtarët të cilët e kanë të bazuar kërkesën në kontratën kolektive. Natyrisht pas kësaj, ne si ekzekutiv do të angazhohemi që të marrim të njëjtat mjete nga ata që e kanë nënshkruar kontratën kolektive, Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit.

z. Tunë Dedaj: Pajtohem që të ju dalim ndihmë të gjithë arsimtarëve por kam një kërkesë nga ju kryetar që shujta të ju paguhet edhe punëtorëve të administratës të cilët kanë paga sa gjysma e pagës së arsimtarëve si dhe punëtorëve shëndetësor.

z. Arben Limanaj: Të gjithë jemi pajtuar këtu që kërkesa e arsimtarëve është më se e arsyeshme dhe kjo është e bazuar në një kontratë kolektive të nënshkruar nga SBASHK dhe Qeveria e Kosovës. Por gjithmonë del problemi të implementimi e marrëveshjeve. Në kontratë kolektive thuhet se Ministria e Arsimit bashkë me Komunën duhet të i siguroj mjetet për implementimin e marrëveshjes. Pagesën e shujtave dhe udhëtimit të arsimtarëve. Pra, në kontratën kolektive thuhet se edhe Komuna duhet të planifikoj buxhet për implementim të kësaj marrëveshje ndërsa ne në linjën buxhetore nuk e pashë që është ky planifikim. Mendoj që do të ketë probleme dhe pengesa në këto pagesa. Uroj që mos të kemi procese gjyqësore edhe për këtë çështje.

z. Fadil Gashi, kryesues: Sot po mundohemi që të i ndihmojmë drejtorisë së Arsimit që ta tërheq ankesën në mënyrë që ta ketë më të lehtë procedurën e pagesave.

Pasi nuk kishte të tjerë të interesuar për debat, kryesuesi e vuri në votim dhe me 15 vota PËR asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA Propozim – Vendimi për tërheqjen e ankesës nga DKA për pagesat e arsimtarëve.

Pika 14 e Rendit të Ditës: Pyetje dhe përgjigje

Z. Azdren Ramadani: Kam një pyetje për drejtorin Lorenc Marleku. A ka mundësi të na tregoni rreth projektit të kanalizimit të ujërave të zeza në fshatin Dollovë. Pse disa shtëpi dhe biznese nuk janë të kyçura në këtë kanalizim, ato të përmendorja e Myrtë Zenelit. Po ashtu në lidhjen me punën që është bërë në këtë projekt ka shumë pakënaqësi rreth kualitetit. Sikurse ankesa të shumta pasi që pas përfundimit të punës, hapësirat nuk janë kthyer në gjendjen e më parshme.

Z. Lorenc Marleku, drejtor i Urbanizmit: Përshëndetje të gjithëve. Ju e dini që disa projekte i kemi nisur me vonesë shkak i pandemisë. Projekti për të cilin pyeti Z. Ramadani nuk ka përfunduar akoma. Është vazhdim i vitit të kaluar, pra, faza e dytë. Para se të bëhet pranimi teknik i projektit do të rregullohet gjithçka.

Z. Isa Ibishi: Një pyetje kryesues pak subjektive tani pasi që u votua buxheti. Dua ta pyes drejtorin e Urbanizmit se qysh që tri vite nuk e ka pa të arsyeshme ta asfaltoj një rrugë 200-300 metra rrugë që të qon tek një fabrikë e bllokave në Bokshiq me 60 qytetarë të punësuar aty, ndërsa asfalti ju ka shkuar edhe vetëm një shtëpie. Që tre vite nuk kemi gjet hapësirë as me e diskutuar këtë çështje.

Z. Lorenc Marleku, drejtor i Urbanizmit: Unë kam qenë aty bashkë me kryetarin dhe me kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj. Ka qenë linja duke punuar atëherë por pas asaj nuk kemi qenë më.

Z. Sefa Morina: Dua të pyes kryetarin nëse ka mbajt takim me bizneset. Disa biznese janë duke punuar të dielave ndërsa në qendër jo. Çështja e dytë është për ujin. Falënderoj drejtorin Elezaj për angazhimin e madh të tij. Ne si lagje kemi bërë një kërkesë për këtë, s' di a është shqyrtuar.

Z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Jam takuar me bizneset, kryesisht me pronarët e marketëve me kërkesë të qytetarëve dhe të tyre pasi që qytetarët në mungesë të dyqaneve të hapura ditën e diele po detyrohen të dalin jashtë Klinës për tu furnizuar. Kemi diskutuar modalitetet se si të ju shërbejmë qytetarëve. Përmes kujdestarisë apo mënyrë tjetër porse zgjidhja përfundimtare do të bëhet me ardhjen dhe votimin e rregullores për këtë çështje, në Kuvend. Sa i përket ujit, është fat i madh se projekti i ujit në vlerë 900 mijë euro nga qeveria Zvicerane do të përfshijë edhe atë pjesë. Është ndalë për disa ditë ky projekt shkak i shtesës së vlerës edhe për 400 mijë euro. Tani vlera investuese për ujin në ato fshatra e që përfshinë edhe Gllarevën tani është 1.300 mijë euro. Brenda 10 ditëve pritet të përfundojnë procedurat e prokurimit dhe shpresojmë që sa më shpejt të bëjmë zgjidhjen e duhur.

Z. Isa Ibishi: I mbeta obligim drejtorit Marleku. Unë fola për tri vite të qeverisë lokale. Atë që e the drejtor, e marr tendencioze dhe po më detyron që edhe atëherë vizitën tuaj ta marr tendencioze. Mendoj që duhet të jesh i kujdesshëm kur të flasësh, po mundohem me të kursye, të lutem të jesh i kujdesshëm.

z. Lorenc Marleku, drejtor i Urbanizimit: Unë deshta të them se ke qenë edhe ti atëherë kur kemi qenë dhe na ke prit edhe ti.

Z, Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Nuk do të ishte mirë të keqkuptohemi. Deri me tani kemi shtruar rrugë vetëm tek familjet, grupe shtëpish dhe jo tek bizneset. Natyrisht që duhet të mendojmë edhe për atë rrugë sepse ti ke 60 punëtorë. Mos e merr tendencioze sepse nuk ka absolutisht asnjë qellim të tillë.

Kryesuesi pasi që nuk kishte më pyetje nga anëtarët e kuvendit për ekzekutivin, e përfundoj seancën duke i falënderuar të gjithë për pjesëmarrje dhe për kontributin e dhënë.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj



Kryesuesi:

Fadil Gashi

